

TITO KOLIANDER

Suedes, lindi në Petrupoli ne vitin 1904, jeton ne shtepine e tij ne Finlande me niper e mbesa dhe vepron energjikisht ne shoqerine ortodokse te Helsinkit. Prodhimi i tij letrar e ka bere te njohur ne te gjithë Skandinavine dhe i dhuroi shume cmime nderi. Ka shkruajtur romane (Kryqezata, Meshira), tregime, poezi(Ne nje shkalle)

dhe shtate permbledhje kujtimesh qe konsiderohen vepra me e frymezuar e tij. Ka perkthyer ne suedisht Meshen Hyjnore te shen Joan Gojartit dhe Himnin Akathist. Mjedisi rus ku jetoi shume vite te jetes se tij dhe tradita ortodokse qe e jeton me pasion te vertete perbejne polet e horizontit te tij shpirtor. Herojte e tij jane njerez te roberuar nga pasionet dhe hovet ku zgjidhja e problemeve te bezdisshme te ndergjegjjes se tyre kerkohet ne vendin e misticizmit ortodoks.

Qe ne moshe shume te re filloi te mendoje mbi Dhimbjen dhe Pajtimin, keshtu qe vepra e tij letrare do te mund te shihej, sic thote edhe vete nen nje hark ku nje baze e tij eshte gjithë urrejtje,zemerim “vjedhes, vjedhes”sic e degjova ne ate avlli te menjanuar te Petrupolit ku, qe femije pashe nje turme njerezish te eger te rrihnin nje burre qe dha shpirt.Baza tjetere e tij, eshte dhe ajo nje britme:” Meshiro Zot”.Eshte pikerisht kjo britme qe papushuar rikthehet ne sherbesat e Kishes Ortodokse.

Kjo natyrisht nuk eshte e pamvarur me aftesine e tij per te kapur “shenjterine ruse”, ku Ptrupit qe rrenqethet nga mekati dhe pikellimi dhe pasioni takon perqafimin e tij pa ikepyetje dhe pretendime dashurie”, sic shenon edhe ai vete ne Kujtimet e tij. Kjo vendosje e tille e tij ka udhehequr disa ta konsiderojne shkrintar te” ndershem”. Ja cfare pergjigjet inteligjenti ortodoks lidhur me kete karakteristike.”Eshte e mundur te me klasifikojne si te tille por une dyshoj se jam i ndershem. Nuk di pikerisht cfare mendojne. Eshte kaq e huaj drejt tradites qe une i perkas, qe te ndaje ne kategori

dhe te thote , ky eshte i ndershem dhe ky tjetri nuk eshte, ky eshte i krishterë i mirë dhe ky tjetri jo. Të gjithë jemi njerëz të pafuqishëm. Askush nuk mund të marrë vendime. Grabitësi me shumë gjak kishte lyer duart e tij. Por në shumë ikona ruse të parajsës ai dhe jo Pjetri qendron në pritje

Perparo ne vendimin tend te ri dhe mos shiko mbrapa. Ashtu si Abrahami degjove zerin e Zotit:”Ik , largohu nga vendi yt , nga te afermit e tu dhe nga shyepia e babait tend dhe shko ne vendin qe do te tregoj.”(Zan:12;1)

Fillimi vendoses

Deshiron te shpetosh shpirtin tend dhe te fitosh jeten e perjeteshme? Vendos qe tani te ndryshosh marshim. Mposht dembelizmin tend, bej shenjen e kryqit dhe thuaj me perzemersi dhe besim: Ne emrin e Atit dhe te Birit dhe te Shpirtit te Shenjte. Amin.

Askush nuk zoteron besimin vetem me mendime te devotshme. Nuk na mesojne fjalet dhe teorite cfare eshte Perendia, por pervoja e jetes shpirtore. Duhet te hapim dritaren qe te hyje brenda ajri I fresket. Duhet te dalim jashte qe te na laje dielli ne driten e tij. Kurre nuk mund te arrijme njer qellim n.q.se qendrojme ne qetesine tone dhe presim thone Eterit e shenjte. Le te behet shembulli yne biri plangprishes: "U cua pra dhe shkoi tek I ati" (Llu:5;20)

Mund te jesh I zhytur ne gjerat tokesore dhe I lidhur zinxhir me to. Kurre nuk eshte vone. Nuk u shkruajt pa arsye ne Shkrimin e Shenjte se Abrahami ishte 75-vjec kur u shperngul nga vendi I tij dhe se punetori qe vjen ne oren e 11 merr te njejten page me ate qe vjen ne mengjes.

Perseri nuk eshte e sakte te mendosh se eshte shume heret. Nje zjarr ne nje pyll nuk shyhet menjehere. Do te deshiroje ne te vertete ta shihje shpirtin tend te shkaterrohej plotesisht nga I ligu?! Leviz pra me veprimtari.

Qe ne castin qe u pagezove more qer detyre te luftosh kunder armiqve te padukur te shpirtit tend. Kete lufte beje qe tani. Mjaft u stepe. I zhytur ne moskujde dhe ne dembelizem le te shkoje e humbur shume kohe e shtrenjte. Per kete duhet te dish: Pastertine qe more me pagezimin tend e le te shtypet dhe te ndyresohet ne menyren me perbuzese.

Ngrehu pra, shpejt pa vonese. Mos e shty vendimin tend "per ne mbasdite", ose "per nesar", ose "per atehere qe sic thua do te jem gati si te mbaroj me pare punen qe kam". Hapesira qedo te jete ne mes do te jete shume e keqe.

Jo! Ne kete ore, ne kete cast qe more vendim je I detyruar te tregosh efektivisht qe mohove "egoizmin" tend te vjeter dhe fillove nje jete me qellime dhe forme te re. Ngrehu pra, pa frike dhe thuaj: Zot ndihmome te filloj tani. Ndhimome! Sepse ajo qe nevojitet mbi te gjitha eshte ndihma e Zotit.

Perparo ne vendimin tend te ri dhe mos shiko mbrapa. Pesimi I gruas se Lotit qe u be gur prej kripe perben per ju nje mesim te rendesishem(Zan 19;26).Ke nxjerre njeriun e vjeter. Ler cdo gje tenden.Ashtu si Abrahami degjove zerin e Zotit”Largohu nga vendi yt, nga te afermit e tu dhe nga shtepia e babait tend dhe shko ne vendin qe do te te tregoj.”(Zan12;1).Drejt ketij vendi duhet te tregosh qe tani e tutje, gjithë kujdesin tend.

Hapi I pare: Konstatimi I pamjaftueshmerise njerezore.

Eterit e Shenjte jane ne nje mendje me kete: Ajo qe duhhet te kesh fillimisht ne mendjen tende eshte te mos besosh ne asnje menyre tek vetja jote.Lufta qe ndermerr tani eshte jashtezakonisht e veshtire.Fuqite e tua jane njerezore dhe te pamjaftueshme per ti bere balle nje lufte te tille. N,q,se mbeshtetesh vetem tek ato, shpejt do te rrezohesh dhe nuk do te kesh oreks per te vazhduar luften.Vetem Perendia mund te te jape fitoren e deshiruar.

Qe te mos besojme tek fuqite tona, perben per shume nje veshtiresi te madhe dhe nje pengese serioze qe ne fillim te jetes shpirterore.Por kete duhet ta mposhtim sepse ndryshe nuk gjendet ndonje perspektive per te vazhduar me tej. Sepse si eshte e mundur te pranoje nje njeri keshilla apo ndihme kur kujton se I di te gjitha dhe nuk ka nevojte per ndonje sugjerim nga ana e te tjereve. Nga nje mur I tille I autarkise nuk mund te kalojne rreze drite.”Mjere ata qe jane te urte ne syte e tyre dhe te zgjuar para vetvetes”(Is:5;21)dhe apostull Pavliu thote:”Mos e mbani veten per te mencur”

(Rom:12;16). Mbreteria e Perendise u zbulohet vetem te thjeshteve dhe te perulurve.Atyre qe e konsiderojne veten e tyre te ditur e te mencur “u fshihet”(Mt:11;25).

Kemi pra detyre te perpiqemi dhe me kujdes te shmangemi nga vetbesimi I madh qe kemi ne veten tone.Eshte kaq I thelle dhe I rrenjzuar brenda nesh aq sa nuk veme re si ka zoteruar zemren tone.Por kerkesa per te kenaqur veten tone dhe egoizmi yne jane shkak I veshtiresive qe takojme, I roberise sone nen tensionin e pasioneve dhe e shqetesimit tone.

VeZgo, pra me kujdes veten tende dhe do te shohesh I lidhur je me pasionet dhe deshirat e tua.Liria jote eshte”e lidhur”dhe keshtu ecen si rob nga mengjesi gjer ne

mbremje:”tani do te pi’,”tani do te ngrihem”,’tani do te lexoj gazen”.Keshtu nga casti ne cast te mbeshjtjellin gjithnje e me shume”prangat “e marrjes me veten tende.Nuk eshte e pashpjegueshme,pra,pse je I pakenaqur dhe pse paraqite3sh I paduruar me me te voglen pengese qe shfaqet ne marrshimin tend.

Vezhgo ne thellesi te qenis sate.Te njejten pamje do te vesh re.Bie lehte ne sy dobesia jote kur te tjeret nuk jane ne nje mendje me ty.Keshtu tregohet se jetojme ne nje gjendje roberie.Dhe shkrimi verteton”Atje ku eshte fryma e Zotit atje eshte liria”(2 Kor:3;17).

Si mund te vije dicka e mire nga nje”une”e tille qe rrotullohet perqark vetes se tij? A nuk na dha Zoti urdher te duam te afermin si vetveten dhe Perendine mbi te gjitha?!Por

Jo!Duhet te bindesh se asgje e mire nuk mund te vije nga ty vete.Dhe n.q.se ndodh qe vjen pa perpjekjen tende nje mendim I mire,atehere meso se nuk vjen nga ty vete por vjen nga burimi I cdo te mire.Eshte dhurate e Perendise se gjalle.E njejta gje ndodh dhe me realizimin e nje vepre te te mire.Nuk kryhet nje veper e mire me fuqite tona por eshte dhurate e Trinise se Shenjte.

Livadhi I zemres

Kjo jete e re ne te cilen ke hyre krahasohet shpesh me punen e kopshtarit.Token qe kultivon e ke nga Perendia.Dhurate e Perendise eshte dhe fara dhe nxehtesia e diellit dhe shiu she rritja e bimes.Por vepra e kultivimit eshte tendja.

N.q.se kopshtari deshiron te kete nje prodhim te pasur duhet te punoje vazhdimisht,te korre te ujise, te gerrmoje,ndryshe gjithcka qe mbolli kercenohet nga shume rreziqe dhe mind te mos mbledhesh asgje ne fund.Asnjehere nuk duhet te ndaloje punen.Ne te kundert,ka per detyre te qendroje I pagjume dhe I gatshem

per cdo te papritur.Por refundimisht prodhimi do te varet nga kushtet e kohes qe Perendia do te rregulloje.

Kopshti qe kemi per detyre te kudesemi dhe te qendrojme pa gjume siper tij vazhdimisht eshte shpirti yne.Prodhimi eshte jeta e perjeteshme.

Jeta e perjeteshme eshte shekullore sepse eshte jashte kohes,vendit dhe rrethanave te jashtme.Jete e perjeteshme do te thote jete e lirise se vertete.do te thote jete e mbushur me drite,dashuri e miresi.Kjo jete nuk kufizohet nga ndonje lloj kufiridhe per kete perparon dhe shtrihet perpara pa mbarim,pa fund.Eshte nje gjendje e pafundme.Jeta e perjeteshme fillon ketu,nga kjo toke por nuk ka fund.Asnje fuqi

tokesore nuk mund te fitoje mbi kete jete dhe ta beje te pushoje se skzistuari.Por jeten e perjeteshme duhet ta kerkojme jo jashte nesh dhe perqark nesh por brenda nesh nesh ne thellesite e zemres sone.

Lufto veten tende-thote shen Isak Siriani,dhe sa me shpejt afrohesh aq me shpejt largohrt armiku.Vendos brenda teje paqen dhe toka e qielli do te lidhin paqe me ty.Perpigu per nje perparim te vazhduar ne jeten jeten shpirtore qe te hysh ne dhomen me te thelle te zemres sate dhe atehere do te zbulosh dhomen qiellore.Sepse qe te dyja jane e njejta gje.Sapo hyn tek njera gjendesh tek te dyja.Skallet per ne Mbreterine e qiellit jane brenda teje te fshehura ne thellsite e zemres tende. Shkarkohu nga mekatet e tua dhe atehere do te gjesh brenda teje shkallet qe te ngjisin lart.

“Dhoma”qiellore per te cilen flet I shenjti I Perendise eshte vete jeta e perjeteshme.Jeta e perjeteshme emerohet dhe Mbreteri e qiejve,Mbreteri e Perendise ose thjesht KRISHT.Se fundi jete e perjeteshme do te thote jete”ne Isu Krisht”

Per luften e heshtur e te padukur

Kur njohim ku behet lufta qe kemi nisur dhe cfare qellimi ka atehere kuptojme perse lufta jone quhet lufte e padukur.Te gjitha ndodhin ne zemer,brenda ne heshtjen e thelle qe mbreteron brenda nesh.Nj kerkese serioze,te ciles eterit e shenjte I japin rendesi te madhe eshte kjo:Mbaj mbyllur buzet e tua per gjithcka qe ka te beje me thellesite e tua mistike.N.q.se ndonjeri hap valvolat,iken nxehtesia qe fshihet brenda ne kaldajen ngrohese.Askush nuk I deshiron me keto valvola qe nuk bejne punen e tyre.

Mos thuaj asgje tek te tjeret per vendimet e tua te reja qe I perkasin jetes tende te brendshme.Nuk eshte e nevojshme te llomotitesh per jeten e re qe ke filluar dhe per pervojen e thelle qe beson se zotyeron.Jeta shpirtorore eshte mistike ne esencen e saj.Eshte ceshtje ndermjet teje dhe perendise,vetem ndermjet ju te dysh.Perjashtimi I vetem mund te jete ati yt shpirtoror.

Kjo heshtje eshte shume e nevojshme dhe me rendesi jetesore per marshimin tend shpirtoror.Sepse cdo njeri qe flet per jeten e tij personale jep ushqim tek vetadhurimi I tij dhe tek egoizmi I tij.Keto duhen luftuar me cdo menyre.Ne te kundert,heshja ndihmon ne rritjen e besimit tek Perendia I cili shikon"fshehurazi".Nepermjet heshtjes dikush ushtrohet te bashkeflase me Perendine qe degjon cfare I themi pa qene te nevojshme llafe dhe fjale.Kjo eshte mbeshtetja jote dhe tek ajo duhet te mbeshtesesh gjithe besimin tend.Je i siguruar ne perjetesi.Dhe atje nuk gjenden asnje lloj fjalesh.

Rrjedhimisht duhet te konsiderosh se cdo gje qe takon ne marrshimin tend,e vogel apo e madhe,e dergon Perndia qe te te ndihmoje ne luften tende.Vetem Ai njeh cfare eshte e dobishme dhe gjithcka per te cilen ke nevojte,ne cdo cast,sukseset,smbropsjet,ngasjet,reniet.Asgje nuk ndodh rastesisht dhe pa perbere rast shume te cmuar te mesosh nga ajo.Duhet ta sqarosh mire brenda teje kete,sepse keshtu rritet besimi yt tek Zoti qe ti vendose te ndjekesh

Nje shenim tjeter per kete lufte qe na japin shenjtet e Perendise eshte dhe kjo.Duhet ta konsiderosh veten tende si nje femije qe meson germat e para dhe hapat e para te qendrueshmerise se tij.Gjithe urtesia njerezore dhe gjithe parapergatitja qe mund te besh nuk ka absolutisht asnje vlere per luften qe more persiper.Njekohesisht,nuk ka ndonje rendesi vendi ytshoqerordhe ndoshta te mirat tokesore qe zoteron.Gjithcka qe nuk vihet ne sherbim te Zotit eshte peshe e padobishme dhe cdo njohje qe nuk cliron veprimtarine e zemres eshte e pafrut dhe per kete e demshme sepse drejtojne zoteruesin e tyre ne krenari dhe vetkenaqesi.Eshte edobishme pra te lesh gjithe njohurite e tua njerezore dhe te behesh”bebe”qe te behesh i ditur.Duhet te behesh i varfer qe te behesh i pasur.Duhet te behesh I semure,shume i semure qe te behesh i fuqishem.

Per mohimin e “une”(egoizmit)dhe per pastrimin e zemres.

I vogel,I zhveshur,I pandihme perparon ne zbatimin e nje prej urdheresave me te veshtira.”Te luftosh me deshirat e tua egoiste”.Perfundimisht kjo do te thote te persekutosh veten tende ndaj se ciles drejtohet lufta jote.Sepse per sa kohe qarkullon deshira jote egoiste nuk mund te lutesh me zemer te paster tek Zoti e ti thuash:U befte deshira jote.N,q,se nuk mohon idene”e madhe”qe ke per veten,nuk do te mundesh me asnje menyre te arrish madheshine e vertete.N,q,se nuk mohon lirine tende (egoiste) nuk do ye shijosh lirine e vertete ku qarkullon vetem nje deshire,e Perendise.

Sekreti I thelle I te Shenjteve eshte ky:Mos deshiro asnje lloj lirie egoiste dhe do te te jepet liria e vertete.

“Ajo do te prodhoje gjemba dhe bime gjembore”.Keshtu I tha Perendia njeriut te rene.Me djersen e ballit dhe me mund duhet te punoje token njeriu.Dhe kjo toke eshte vete vetja jote.Me mundim te madh do te zoterosh pasurine tende shpirtore,thote shen Makari.Sepse nuk kontribon ne realizimin e shpetimit tend te zoterosh te mirat pa mundim.Kjo te ben krenar.

Por,si mundet dikush te luftoje veten e tij?!